



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2699/2 prot

Datë 07.11.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET PËR ANULIMIN PROCEDURËS SË PROKURIMIT, SI
DHE
MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË TJERË DUKE
REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT NGRIHEN PRETENDIME

Objekt:

Anulimin e procedurës së prokurimit “*Proçedurë e hapur e thjeshtuar – shërbime , nëpërmjet marrëveshjes kuadër, me një ose më shumë operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*”, me Nr. REF- 81675-09-28-2023, me objekt: Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore”, *Loti I: REF-81681-09-28-2023 me objekt Loti I : “Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore” (per landfillin) me fond limit 3.000.000 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 10.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria “ECO – ELB” SHA.*

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK në procedurën e e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK në procedurën e e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga

operatori ekonomik “GR Albania” SHPK në procedurën e e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK, me NIPT K92402036A, me adresë: Zona Kadastrale 2679, Hyrja 2, Ap.39, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Shoqëria “ECO – ELB” SHA, me adresë: Lagja “Brigada 17 Sulmuese”, Bulevardi “Qemal Stafa”, Elbasan

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, me NIPT L51512009E, me adresë: Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Irfan Tomini”, Pallati nr.50, Kati I - rë, Tiranë

Operatori ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK, me NIPT L81904506I, me adresë: Rruga dytësore “Maminas – Sukth”, Km.2, Durrës

Operatori ekonomik “GR Albania” SHPK, me NIPT L01509004N, me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, Ndërtesa Nr. 19, Hyrja Nr. 8, Kodi Postar 1019, Tiranë

Në datën 06.11.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3562, si dhe nr. protokollit 2699/2023 datë 06.11.2023 e operatorit ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar – shërbime , nëpërmjet marrëveshjes kuadër, me një ose më shumë operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*”, me Nr. REF- 81675-09-28-2023, me objekt: Monitorimi i parametrevë mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore”, *Loti I: REF-81681-09-28-2023 me objekt Loti I : “Monitorimi i parametrevë mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore” (per landfillin)* me fond limit 3.000.000 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 10.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria “ECO – ELB” SHA.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kërkesën për anulimin e procedurës së prokurimit, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqiturë nga operatorët ekonomikë “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, “Tenuis Laboratories” SHPK dhe “GR Albania” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Operatori ekonomik ankimues kërkon anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit duke pretenduar se:

“[...] Urdheri nr.77 date 02.07.2020 është shfuqizuar me daljen e urdherit nr.126 date 10.06.2022 “Per proceduren e dorezimit/pranimit te dokumenteve dhe raporteve te vetemonitorimit, per subjektet e pajisur me leje mjedisi te tipit A ose B”. Pra autoriteti kontraktor i është referuar per kryerjen e specifikimeve teknike nje baze ligjore te shfuqizuar.

Nga ana tjetër ne listen e dokumentave te listuara gjithashtu mungon kerkesa per dokumentin nr.17 Plani i mostrimit (per vitin aktual ushtrimor, per secilin 3 mujor apo 6 mujor raportimi), kushti 12 i lejes mjedisore, e cila është kerkese e urdherit nr.126 date 10.06.2022 “Per proceduren e dorezimit/pranimit te dokumenteve dhe raporteve te vetemonitorimit, per subjektet e pajisur me leje mjedisi te tipit A ose B”, gje e cila tregon edhe nje here qe ne te vertete autoriteti kontraktor i është referuar nje baze ligjore te shfuqizuar. Pervec ndryshimit te sipercituar po listojme me poshte edhe ndryshimet e tjera midis urdher nr.77 date 02.7.2020 dhe urdher nr.126 date 10.06.2022:

6. Operatoret e pajisur me leje mjedisi te tipit A dhe B ne dokumentacionin vjetor mbi zbatimin e kushteve te lejes, dorezojne prane AKM-se planin e mostrimit te miratuar nga operatori per parametrat e shkrakimit per vitin pasardhes, ku te percaktohet data/muaji/viti/ora dhe vendi i marrjes se mostres.

7. Operatoret e pajisur me leje mjedisi te tipit A dhe B ne rastet kur per pergatitjen e raporteve te vetmonitorimit marrin mostra, se bashku me dokumentacionin sipas Aneksit 1 te ketij urdheri perfshijne dokumenta provuese nga procesi I marrjes se mostres (foto-video).

8. Operatoret se bashku me raportet e testimit/analizat qe dorezojne prane AKM-se bashkelidhin dhe autorizimin per laboratorin e akredituar per marrjen e mostres, testimin dhe analizimin e saj

9. Kur dokumentacioni mbi zbatimin e kushteve periodike dhe vjetore nuk dorezohet nga vete operatori i lejes mjedisore, personi i cili ben dorezimin e dokumentacionit prane AKM-se, paraqet autorizimin e perfaqesimit nga operatori.

10. Sektori i Monitorimit prane Agjencise Kombetare te Mjedisit ne rastet kur dokumentacioni i kerkuar nuk është sipas kerkeseve te ketij urdheri, nuk pranon shqyrtimin e tyre dhe njofton menjehere operatorin e lejes mjedisore si dhe laboratorin e autorizuar ose personin e autorizuar.

11.Per zbatimin e ketij urdheri ngarkohet Drejtoria e Inspektim Kontrollit prane Agjencise Kombetare te Mjedisit

12. Me miratimin e ketij urdheri, shfuqizohet urdheri nr.77, date 02.07.2020.

Urdheri nr.126 date 10.06.2022 “Per proceduren e dorezimit/pranimi te dokumenteve dhe raporteve te vetemonitorimit, per subjektet e pajisur me leje mjedisi te tipit A ose B”. po e bashkengjisim ketij dokumenti.

Per sa me siper kerkojme anullimin e procedures se prokurimit si e pa bazuar ne ligj.”

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, “Tenuis Laboratories” SHPK dhe “GR Albania” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht për operatorët ekonomikë “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, “Tenuis Laboratories” SHPK dhe “GR Albania” SHPK, operatori ekonomi ankimues pretendon se nuk përmbushin kriteret si më poshtë:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

[...]

Specifikimet teknike në lidhje me impiantin.

Parametrat e ujit që do të analizohen.

<u>Nr.</u>	<u>Parametri</u>	<u>Vendi I mostrimit</u>
1	pH	Shkarkim ne kanalizime, Shkarkim ne ujera siperfaqesore
2	Rrjedhja ditore m^3 ,Niveli max i rrjedhjes m^3/ore	Shkarkim ne kanalizime, Shkarkim ne ujera siperfaqesore
3	Temperatura	Shkarkim ne kanalizime Shkarkim ne ujera siperfaqesore
4	Lëndët në pezulli	Shkarkim ne ujera siperfaqesore
5	Nevoja biokimike për oksigjen, (BOD5)	Shkarkim ne ujera siperfaqesore
6	Nevoja kimike per oksigjen, COD	Shkarkim ne ujera siperfaqesore
7	Nitrati total (N-NO3-)	Shkarkim ne ujera siperfaqesore
8	Nitrat Amoni	Shkarkim ne ujera siperfaqesore
9	Fenolet volatile	Shkarkim ne ujera siperfaqesore

10	<i>Benzeni</i>	<i>Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
11	<i>Toksiciteti</i>	<i>Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
12	<i>Oksigjeni i tretur, DO</i>	<i>Shkarkim kanalizime</i>
13	<i>Përbërësit organikë të fosforit (P-org)</i>	<i>Shkarkim kanalizime</i>
14	<i><u>Percjellshmeria elektrike</u></i>	<i>Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
15	<i><u>Azot amoniaku N</u></i>	<i>Shkarkim ne kanalizime</i>

Parametrat e ajrit qe do te analizohen.

<i>Nr.</i>	<i>Parametri</i>	<i>Vendi I mostrimit</i>
1	<i>SO2</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
2	<i>NO2</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
3	<i>NOx</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
4	<i>O2</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
5	<i>CO</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
6	<i>CxHx</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
7	<i>Lenda e ngurte totale</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
8	<i>HCL</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
9	<i>HF</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
10	<i>TM (Sb+As+Pb+Cr+Co+Cu+Mn+Ni+V)</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
11	<i>Cd & TL</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
12	<i>Hg</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
13	<i>PCDD/PCDF</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
14	<i>Temperatura, Presioni</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
15	<i>SHpejtesia</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
15	<i>Grimca</i>	<i>Ajri I ambientit</i>
16	<i>PM10</i>	<i>Ajri I ambientit</i>
17	<i>Zhurmat ne ambient</i>	<i>Ne 8 pika (sipas percaktimeve ne lejen mjedisore)</i>

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.2 Ofertuesi duhet të ketë në pronësi laborator të akredituar sipas standartit S SH ISO IEC 17025:2017, për fushat : analiza ujërash (ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore), niveli i zhurmë, cilësia e ajrit (gaze dhe grimcat).

2.3.7 Operatori Ekonomik, duhet të vërtetojë se posedon të paktën 1 (një) pajisje laboratorike, për të bërë të mundur matjen e cdo parametri te listuar .

2.3.8 Operatori Ekonomik, të ketë të paktën përvojë pune 2 (dy) vjeçare në fushën objekt i kësaj gare, duke plotësuar kriteret kualifikiuese për këtë periudhë.

Gjithashtu, operatori ekonomik ankimues pretendon se oferta e operatorit ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK është anomalisht e ulët.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 07.11.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anëtar

Anila Malaj

Kreshnik Ternova

Nënkryetar

Fiorent Zguro